



Pranuar / Doretuar Prilbjen / Prodato Received / Delivered	27.10.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPJESHK	6723	2023	1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1214/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1214/2023 të datës 26.09.2023, të parashtruar nga ankuesja [redacted] të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat [redacted] me adresë rruga [redacted] në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.1494/2023 të datës 19.09.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 27.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1214/2023 e datës 26.09.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II. **Anulohet** Vendimi me Nr.1494/2023 i datës 19.09.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- III. **Obligohet** Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të bëjë zbatimin e këtij vendimi, duke e kthyer ankuesen në vendin e punës dhe duke bërë kompensimin e 50% të pagës nga data 12.07.2023 deri në zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Policisë së Kosovës më date 05.07.2023 ka njoftuar Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme se ankuesja është intervistuar në cilësinë e të dyshuarës për shkak të dyshimit për Keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe marrje e ryshfetit.

Sekretarja e Përgjithshëm e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndaj ankuseses Nora Shabani e punësuar sipas Akt Emërimit me Nr. prot: 80 të datës 25.11.2013 në pozitën *Koordinatorë e Projekteve të Arkitekturës dhe Ndërtimitarisë*, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 10.07.2023 ka parashtruar kërkesë që ankuesja të pezullohet nga detyra.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 12.07.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. 1133/2023 përmes të cilit ka bërë pezullimin nga marrëdhënies e punës së ankuseses deri në marrjen e një vendimi tjetër dhe e njëjta do të kompensohet në vlerën prej 50% të pagës së plotë duke përjashtuar çdo lloj shtese në pagë për një periudhë pezullimi deri në gjashtë (6) muaj.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr. 1133/2023 të datës 12.07.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 18.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 5265/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes Vendimit A.nr.1003/2023 të datës 29.08.2023 ka anuluar vendimin e datës 12.07.2023 të Komisionit Disiplinor duke e obliguar të njëjtin të rishqyrtoj rastin e ankesës. Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 19.09.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. 1494/2023 me të cilin ka pezulluar nga marrëdhënies e punës ankuesen deri në marrjen e një vendimi tjetër dhe për këtë do të kompensohet me 50% të pagës.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr. 1494/2023 të datës 19.09.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 26.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 6273/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 03.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli me datë 11.10.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 6273/2023 të parashtruar nga ankuesi me datë 26.09.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 1494/2023 të datës 19.09.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Akt Emërimit e datës 25.11.2013 të ankuseses; Kërkesën e

datës 10.07.2023 të Sekretares së Përgjithshme; Emailin e datës 05.07.2023 nga Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Korrupsionit në Policinë e Kosovës; Emailin e datës 04.07.2023 nga F.T për L.I; Informimin e datës 11.07.2023 nga Policia e Kosovës; Vendimin me Nr. 1133/2023 të datës 12.07.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimin A.nr.1003/2023 të Këshillit; Autorizimin e datës 21.09.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 03.10.2023; Përgjigje në ankesë e datës 11.10.2023; Procesverbalin e datës 12.07.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar se ankesa e ankueses është e bazuar, *sepse*:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 1494/2023 të datës 19.09.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, pretendon për shkelje procedurale dhe materiale, me theks të veçantë pretendon se nuk kemi të bëjmë me kërkesën për inicim të procedurës disiplinore për shkelje të rënda disiplinore por kemi të bëjmë me kërkesën për pezullim të marrëdhënies së punës; Komisioni Disiplinor ka marr kompetencat e gjykatës sepse në këto raste duhet të kemi vendim të organit gjyqësor; Komisioni Disiplinor nuk ka marr parasysh udhëzimet e dhëna sipas Vendimit A.nr.1003/2023 të Këshillit pasi që ka vendosur njëjtë si në rastin e parë; duke kërkuar që ankesa të aprovohet të anulohet vendimi i kontestuar dhe të kthehet në punë sipas akt emërimit dhe të bëhet kompensimi i 50% të pagës nga data 12.07.2023 deri në zbatimin e vendimit.

Kolegji i Këshillit, lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se Komisioni Disiplinor duhet të shqyrtoj rastet vetëm ku ka kërkesë për inicim të procedurës disiplinore për supozim të shkeljeve të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa në rastin konkret nëse shohim kërkesën e datës 10.07.2023 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme mund të konkludohet që e njëjta nuk përmban elementet e një kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore, ngase nuk përcakton kualifikimin e shkeljeve disiplinore dhe nuk përcakton se cilat janë shkeljet e supozuara, mirëpo sipas kësaj kërkesë vetëm është kërkuar që ankuesja të pezullohet nga detyra, kështu që në kuadër të kësaj kërkesë Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme sipas Vendimit me Nr.1133/2023 ka vendosur për pezullim të marrëdhënies së punës së ankueses për një periudhë prej gjashtë (6) muaj. Si rezultat i kësaj Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin A.nr.1003/2023 ka obliguar Komisionin Disiplinor që në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06.L-114 për Zyrtarët Publikë të rishqyrtoj rastin e ankueses, mirëpo Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme përmes Vendimit me Nr.1494/2023 të datës 19.09.2023 ka vendosur pothuajse në mënyrë identike si në rastin e parë vetë që në këtë rast ka hequr kufizimin e pezullimit prej gjashtë (6) muajsh.

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimit me Nr. 1494/2023 të datës 19.09.2023, e që ka të bëjë me pezullimin e marrëdhënies

së punës së ankueses Kolegji i Këshilli, ju referuar dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me pezullimin e marrëdhënies së nëpunësit civil, konkretisht sipas nenit 55 të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcaktonte se: *"1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, i cili bëhet: 1.1. sipas detyrës zyrtare; apo 1.2. me kërkesë të nëpunësit civil"*, po ashtu sipas nenit 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcaktohet se: *"1. Nëpunësi civil pezullohet, sipas detyrës zyrtare të organit përkatës të punëdhënësit, në rastet si në vijim: 1.1. në rastin e procedurës disiplinore sipas paragrafit 5 të nenit 48 të këtij ligji"*, ndërsa neni 48 paragrafi 5 i të njëjtit ligj përcaktonte se: *"Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedurë disiplinore, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar"*, andaj duke iu referuar akteve normative të lartcekura dhe të aplikuara në këtë periudhë, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit arrihet në përfundimin se Komisioni Disiplinor ka diskrecion që të pezullojë nga puna nëpunësin civil ndaj të cilit është duke u zhvilluar procedura disiplinore, vetëm për periudhën kohore sa zhvillohet procedura disiplinore, gjegjësisht deri në marrjen e vendimit përfundimtar, nga rrjedh se kuptimi i kësaj norme ndërlidhet me përfundimin e procedurës disiplinore dhe vendimmarrjen brenda afateve të përcaktuara kohore siç përcaktohet me nenin 12 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë: *"Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për inicim të procedurës nga njësia për burime njerëzore"*.

Andaj nisur nga dispozitat ligjore të analizuara si më lartë, Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 1494/2023 të datës 19.09.2023, nuk ka vepruar në mënyrë të drejtë dhe ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material, ngase ka bërë pezullimin e marrëdhënies së punës së ankueses deri në një vendim tjetër dhe gjatë këtij pezullimi do t'i paguhet paga prej 50%, kur dihet fakti se në kuptim të nenit 58 paragrafi 4 të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: *"4. Nëpunësi civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1.1 të nenit 56, në rast se procedura përfundon pa një masë disiplinore dhe në rastin e përcaktuar në paragrafin 1.7 të nenit 56, nëpunësi përfiton 50 për qind të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtese në pagë për një periudhë pezullimi deri në 6 muaj"*, nga rrjedh se në rastet kur kemi të bëjmë me procedurë penale ndaj nëpunësit civil sipas normave ligjore të aplikueshme Komisioni Disiplinor nuk mund të bëjë pezullimin e marrëdhënies së punës së nëpunësit civil në këtë rast ankueses nga se nuk kemi ndonjë bazë ligjore në bazë të së cilës është nxjerrë ky vendim, përkatësisht nga provat e lëndës nuk kemi hasur në ndonjë shkresë mbi të cilin përveç tjerash është bazuar kjo vendimmarrje kështu që në rastin konkret të ankueses Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme ka dal përtej mandatit dhe kompetencave të tyre ligjore, ngase në kuptim të nenit 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohej se: *"1. Nëpunësi civil pezullohet, sipas detyrës zyrtare të organit përkatës të punëdhënësit, në rastet si në vijim: 1.4. kur gjykata vendos ndaj nëpunësit civil si masë parandaluese penale pezullimin e ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik, sipas ligjit në fuqi"*, nga rrjedhë se sipas kësaj norme vetëm gjykatës i është njohur kjo e drejtë apo kompetencë që ndaj nëpunësit civil mund të vendos masë parandaluese penale me qëllim të pezullimit të ushtrimit të detyrës zyrtare, deri në vendosjen meritore.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se çështja e institutit të pezullimit të marrëdhënies së punës është rregulluar me nenin 56 të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ku ka përcaktuar nëntë (9) raste kur nëpunësit civil mund të pezullohen nga marrëdhënia e punës sipas detyrës zyrtare, dhe nga të gjitha këto vetëm për një (1) rast i është rezervuar e drejta diskrecionale Komisionit Disiplinor që të pezullojë nëpunësin civil sipas detyrës zyrtare siç përcaktohet me nenin 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht në rastet kur ndaj të njëjtit hapet apo inicohet procedurë disiplinore, mirëpo vetëm deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar që zgjidh çështjen juridike brenda afateve kohore të përcaktuara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, ndërsa Kolegji i Këshillit, thekson faktin se Vendimi me Nr.1494/2023 i datës 19.09.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme nuk është vendim përfundimtar në procedurë administrative, ngase përmes të njëjtit nuk është zgjedhur çështja juridike sipas kërkesës së datës 10.07.2023, gjegjësisht me vendimin e njëjtë nuk është konfirmuar nëse ankuesja ka kryer shkelje disiplinore apo jo.

Po ashtu, Kolegji i këshillit vlerëson se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme me rastin e vendosjes sipas Vendimit me Nr. 1494/2023 të datës 19.09.2023, i' u është referuar emailit të datës 05.07.2023 dhe shkresës informuese të datës 11.07.2023 të Policisë së Kosovës e përmes kësaj të fundit potencohet se ndaj ankueses është dorëzuar kallëzim penal për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe marrje e ryshfetit, kështu që sipas Kolegjit të Këshillit, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme para vendosjes së kësaj çështje është dashur që të vërtetoj faktin nëse ndaj ankueses është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale nga organet e drejtësisë, me qëllim që të vihet deri tek një përfundim i drejtë dhe i saktë në mënyrë që të vie në shprehje pezullimi i procedurës disiplinore ndaj nëpunësit civil dhe të aplikohen dispozitat e nenin 85 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 1494/2023 të datës 19.09.2023, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit material si dhe kompetencat e përcaktuara me nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe si i tillë është i paligjshëm në kuptim të nenin 52 paragrafi 1 në paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, po ashtu me këtë vendim nuk janë marr për bazë udhëzimet e dhëna me Vendimin A.nr.1003/2023 të 29.08.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara.

Përveç konstatimeve të potencuara si më lartë e që rezultojnë se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme ka dalur jashtë mandatit të tij ligjor dhe meqë nuk kemi pasur vendim të gjykatës për pezullim të ushtrimit të detyrës zyrtare, duke marr parasysht rrethanat e rastit të ankueses, Kolegji i Këshillit, konstaton se organi i punësimit, me një konstatim të drejtë të gjendjes faktike dhe eliminimit të çështjeve të tjera që ndërlidhen me pozitën e ankueses ka mundur të veprojnë në një mënyrë tjetër, e që Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i ka rregulluar sipas nenit 52.

Bazuar si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, është e obliguar që ankuesen ta kthej në vendin e punës dhe të bëjë kompensimin e 50% të pagës nga data 12.07.2023 deri në zbatimin e këtij vendimi.

Keshtu që pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1262/2023, datë 27/10/2023.

Avdyl BEKTESHI

Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arban MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses,
- Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.